



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 314/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar.

Aleancës Kosova e Re (AKR), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3000 (tremijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimi të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik AKR, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, sepse subjekti politik AKR, i ka mbuluar posterat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja, duke i vendosur posterat e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Avni Dervishi.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2010, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja, në të cilën theksohet subjekti politik AKR i ka mbuluar posterat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja, duke i vendosur posterat e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Avni Dervishi, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterat e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Avni Dervishi, nga radhët e subjektit politik AKR, është vendosur mbi posterat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik AKR, më datë 04.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, më datë 04.12.2010, pranoi përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik AKR, në të cilën theksohet se; vendosjen e posterit në fjalë nuk e kanë bërë kandidatët e këtij subjekti politik, sipas përgjigjeje në ankesë, këtë ka mund të bëjë çdo kush, këtë ka mund ta bëjë edhe qytetari i cili është adhurues i kandidatit të paraqitur, prandaj konsiderojnë se një foto e tillë të cilës i mungon identifikimi i të vendosurit të posterit konsiderohet si e pabazë, sipërfaqësore dhe e papranueshme për këtë subjekt politik.

Përgjigjejes në ankesë subjekti politik AKR nuk ju ka bashkangjitur asnjë provë që tregon se ky subjekt politik ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar shkeljen e këtij Kodi.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërës si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;

- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Përgjegjësit e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve, parashihen në; Nenin 32 paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7, të LZP-së.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posterit i kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Avni Dervishi, nga radhët e subjektit politik AKR, është vendosur mbi posterat subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja. Nga përgjigjja në ankesë e subjektit politik AKR del se ky subjekt politik nuk ka bërë ndonjë përpjekje serioze për të parandaluar shkeljen e këtij Kodi, e që do të kishte ndikim në marrjen e këtij vendimi. Prandaj nga këto arsye dhe më qëllim të evitimit të shkeljes së lartcekur po ashtu në pajtim më dispozitat e lart cekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

A nr. 314/2010 më datën 06.12.2010

